



---

**RREGULLORE NR. 2005/31**

**MBI SHPALLJEN E LIGJIT PËR TEATRIN TË MIRATUAR NGA KUVENDI I  
KOSOVËS**

Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm,

Në pajtim me autorizimin që i është dhënë me Rezolutën 1244 (1999) të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara (RKSKB) të datës 10 qershor 1999,

Në harmoni me nenet 9.1.44 dhe 9.1.45 të Kornizës Kushtetuese për Vetëqeverisje të Përkohshme në Kosovë (Rregullorja e UNMIK-ut nr. 2001/9 e datës 15 maj 2001),

Duke marrë parasysh shkresën zyrtare nga Kryetari i Kuvendit të Kosovës të datës 12 prill 2005 lidhur me Ligjin për teatrin të miratuar nga Kuvendi më 23 mars 2005,

Duke ditur se dispozitat e Ligjit nuk e cenojnë autoritetin e Përfaqësuesit Special të Sekretarit të Përgjithshëm sipas RKSKB 1244 (1999) apo pushtetin dhe kompetencat e tij të rezervuara sipas Kornizës Kushtetuese për Vetëqeverisje të Përkohshme në Kosovë,

Me anë të kësaj shpall Ligjin për teatrin i miratuar nga Kuvendi i Kosovës (Ligji nr. 02/L-12), që i bashkëngjitet kësaj Rregulloreje, i cili bëhet i plotfuqishëm në datën e nënshkrimit, me kusht që:

(a) Fjalët “Teatri Kombëtar i Kosovës” kudo që paraqiten në këtë ligj të zëvendësohen me “Teatri i Kosovës”,

(b) Në nenin 15, fjalët “vendor apo të jashtëm” të zëvendësohen me “nga Kosova ose jashtë saj”.

(c) Në nenin 24, fjalët “kombëtare” pas “vlera“ të zëvendësohen me “kosovare”.

Këto ndryshime do të paraqiten në tekstin përfundimtar zyrtar të Ligjit.

Nënshkruar sot, më 8 qershor 2005.

Søren Jessen-Petersen  
Përfaqësues Special i Sekretarit të Përgjithshëm